

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil takim pune me përfaqësues të Ambasadës së SHBA-ve në Tiranë

Komisionerja për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Leterije Lleshi (Luzi), mirëpriti në zyrën e saj një përfaqësi nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri.



Komisionerja njohu bashkëbiseduesit me mandatin dhe pritoritetet e institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe gjatë bisedës u shkëmbyen edhe mendime mbi zhvillimet dhe reformat e ndërmarra në administrimin e shërbimit civil në Shqipëri.



Takimi u fokusua më tej në çështje që lidhen me forcimin e dialogut institucional dhe bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë, ku Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerësoi rolin dhe kontributin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në reformat kyçe të institucioneve në Shqipëri.